



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 271

Tiranë – E premte, 20 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 140/2016 datë 22.12.2016	Për disa ndryshime në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”..... 27687



LIGJ
Nr. 140/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
155/2015 “PËR LOJËRAT E FATIT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 7, pika 4, fjalët “31 dhjetor 2016” zëvendësohen me fjalët “31 dhjetor 2018”.

Neni 2

Në nenin 9 bëhet ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Ndalohet reklamimi i aktivitetit të lojërave të fatit, në pjesën e jashtme të pikave/sallave të ofrimit të lojërave të fatit për çdo kategori, sipas këtij ligji, me përjashtim të tabelës identifikuese. Formatit dhe përmasat e tabelës identifikuese përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Brenda një periudhe njëmuajore nga hyrja në fuqi e udhëzimit, organizatorët e lojërave të fatit marrin masat për zbatimin e këtij detyrimi. Në rast se brenda kësaj periudhe organizatorët nuk kanë marrë masat për ndryshimin e formatit dhe përmasave të tabelave identifikuese, sipas këtij udhëzimi, zbatohen masat administrative të parashikuara në nenin 53 të këtij ligji.”.

2. Në fjalinë e dytë të pikës 6, fjalët “si dhe gjatë emisioneve sportive” hiqet.

Neni 3

Në nenin 70 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Formatit dhe përmasat e tabelave identifikuese në pjesën e jashtme të pikave/sallave

të ofrimit të lojërave të fatit për çdo kategori përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave që miratohet brenda datës 31 janar 2017.”.

2. Kudo në këtë nen fjalët “brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 31 janar 2017”.

Neni 4

Në nenin 71 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organizatorët e kazinove elektronike dhe bingo tradicionale, të cilat janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin vetëm në pikat që janë hapur në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në datën 31 dhjetor 2018. Gjatë kësaj periudhe tranzitore nuk lejohet hapja e pikave të reja sekondare për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëritë e licencuara për kazino elektronike dhe bingo tradicionale. Pikat që mbyllen për këto kategori gjatë periudhës tranzitore nuk mund të rihapen.”.

2. Në pikën 3, fjalët “31 dhjetor 2016” zëvendësohen me fjalët “31 dhjetor 2018”.

Neni 5

Në nenin 72 bëhet ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i fundit i pikës 4.2 shfuqizohet.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Organizatorët e lojërave të fatit, sipas kategorive përkatëse, derdhin në llogari të ministrisë përgjegjëse për sportin, ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin shumë përkatëse, sipas parashikimeve të nenit 52 të këtij ligji.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.12.2016

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë